

Përmbledhje

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka shënuar rritje prej 5.3 përqind në vitin 2021. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, si rezultat i përmirësimit të situatës pandemike, lehtësimit të masave kufizuese si dhe politikës mbështetëse fiskale dhe monetare. Rritja ekonomike humbi momentumin në TM4 2021, kryesisht si pasojë e variantit të ri të koronavirusit “Omicron” dhe rikthimit të masave në vende të ndryshme, si dhe rritjes së çmimit të energjisë dhe problemeve evidente në zingjir të furnizimit. Për shkak të pasigurive që ka shkaktuar lufta në Ukrainë, BQE rishikoi projeksionet makroekonomike në mars 2022, duke prezantuar tre skenar për rritjen ekonomike dhe shkallën e inflacionit. Skenari bazë sugjeron se rritja reale e BPV-së në vitin 2022 do të jetë 3.7 përqind, pasuar nga një rritje më e ngadalëshme prej 2.8 përqind në 2023 dhe 1.6 përqind në 2024.

Edhe në vendet e rajonit është shënuar rritje e lartë e aktivitetit ekonomik deri në shtator 2021, dinamikë që rezultoi në jetë dobësuar në tremujorin e katërt të vitit. Serbia dhe Maqedonia e Veriut raportuan rritje të aktivitetit ekonomik prej 7.0 përkatësisht 2.3 përqind, ndërsa vendet tjera ende nuk i kanë publikuar vlerësimet e tyre. Vlerësimet e FMN-së për vitin 2021 sugjerojnë rritje të aktivitetit ekonomik prej 5.3 përqind për vendet e Ballkanit Perëndimor ndërsa parashikimet e realizuara në tetor 2021 sugjeronin ngadalësim të rritjes prej 4.4 përqind në vitin 2022. Përderisa rreziqet në lidhje me pandeminë janë zvogëluar, lufta në Ukrainë do të reflektohet në një rritje edhe më të ngadalësuar në vendet e rajonit.

Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 10.5 përqind në vitin 2021. Kjo rritje e lartë e aktivitetit ekonomik kryesisht i'u atribua përmirësimit të të krizës shëndetësore – dinamikë që u reflektua në lehtësim të masave kufizuese dhe rritje të të hyrave nga jashtë (kryesisht diasporës), dhe politikave stimuluese financiare dhe fiskale. Vetëm në TM4 2021, rritja reale e BPV-së rezultoi të ketë qenë 6.4 përqind, mbështetur nga rritja e kërkesës vendore ndërkohë që eksportet neto kishin kontribut negativ në aktivitetin e gjeneruar ekonomik.

Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik, shoqëruar me presionet e jashtme inflacioniste si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë dhe çmimeve të mallrave të importuara nga vendet partnere u përkthye në rritje të çmimeve të përgjithshme edhe në Kosovë. Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje prej 3.4 përqind në vitin 2021, ndërsa rritja më e lartë e çmimeve të konsumit është evidentuar në TM4 2021 kur është shënuar normë mesatare e inflacionit prej 6.4 përqind.

Rritja e aktivitetit ekonomik në periudhën raportuese është shoqëruar me përmirësimin e performancës së të hyrave buxhetore gjatë vitit 2021. Vetëm në TM4 2021, të hyrat buxhetore shënuan rritje prej 12.9 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej vetëm 0.7 përqind. Borxhi publik ka vazhduar me rritje dyshifrore prej 13.1 përqind dhe ka arritur vlerën 1.68 miliardë euro, përderisa si përqindje e BPV-së, ka arritur në 23.3 përqind në TM4 2021.

Aktiviteti i gjeneruar në kuadër të sektorit të jashtëm rezultoi të ketë pasur peshën kryesore në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend në vitin 2021. Rritja e të hyrave nga diaspora përmes kanaleve kryesore si remitencat, shpenzimet e udhëtimit dhe blerja e patundshmërive u përkthye në rritje të kërkesës së përgjithshme në vend, duke mbështetur si rritjen e konsumit ashtu edhe të investimeve në vitin 2021. Rritja e kërkesës së brendshme rezultoi në rritje të importeve, gjë që përkeqësoi bilancin e mallrave, përkundër rritjes që shënuan eksportet. Vetëm në TM4 2021, deficitit tregtar i mallrave është rritur për 34.4 përqind dhe ka arritur nivelin prej 1.0 miliardë euro, ndërsa bilanci i shërbimeve arriti vlerën prej 139.2 milionë euro nga 95.2 milionë euro në TM4 2020.

Sistemi financiar u karakterizua me rritje të aktivitetit në të gjitha segmentet përbërëse të tij. Sektori i shëndetshëm bankar (shkallë e lartë e kapitalizimit, likuiditetit dhe cilësi e lartë e portfolios kreditorë) pati rol të rëndësishëm në financimin e aktivitetit ekonomik përgjatë gjithë vitit 2021. Rritja e kreditimit bankar u mbështet si nga masat financiare të ndërmarra nga BQK, zbutja e rreziqeve të përceptuara nga sektori bankar, rritja e depozitave të përgjithshme dhe rritja e kërkesës me rritjen e kapacitetit absorbues në vend. Për vitin 2022, bankat presin një rritje më të kontrolluar të kreditimit prej rreth 15.6 përqind, rritje që do të mbështetet kryesisht nga depozitat që priten të rriten për rreth 5.0 përqind. Sektori pensional vitin 2021 e mbylli me nivel të lartë të kthimit nga investimet, pavarësisht luhatjeve në tregjet e jashtme si pasojë e pandemisë. Kontributet nga kontributdhënësit vazhduan të rriten me ritëm të qëndrueshëm, edhe pse me intensitet më të ulët. Viti 2022 shoqërohet nga shumë pasiguri, dhe performanca e tregjeve financiare është subjekt i ndikimit që do të kenë saksionet ekonomike ndaj Rusisë si pasojë e luftës së filluar në Ukrainë dhe efekteve tjera zingjirore. Sektori i sigurimeve u zgjerua si rrjedhojë e nivelit më të lartë të primeve të shkruara krahasuar me vitin 2020, kurse gjatë vitit 2022, pritet që të rritet me ritëm më të ulët (nivel para pandemik). Rritja e sektorit mikrofinanciar u mundësua kryesisht prej huazimeve prej institucioneve financiare (kryesisht jashtë vendit), që vazhdojnë të kenë peshën më të lartë në gjithsej detyrimet, pasuar nga kapitali vetanak dhe llogaritë e pagueshme.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	1
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	6
Ekonomia e Kosovës -----	7
Spektori Real -----	7
Çmimet -----	8
Spektori Fiskal -----	9
Spektori i Jashtëm -----	10
Sistemi Financiar -----	14
1. Spektori Bankar -----	14
1.1. Bilanci i gjendjes - Asetet -----	14
Performanca e sektorit bankar -----	20
Spektori pensional -----	24
Spektori i sigurimeve -----	25
Performanca e sektorit të sigurimeve -----	26
Spektori mikrofinanciar -----	27
Asetet -----	27
Performanca e sektorit mikrofinanciar -----	29
Tregu i letrave me vlerë -----	30

GRAFIKËT DHE TABELAT

Grafik 1. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë	07
Grafik 2. Inflacioni i përgjithshëm	08
Grafik 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj	11
Grafik 4. Eksporti dhe importi i mallrave	11
Grafik 5. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave	11
Grafik 6. Kategoritë kryesore të importit të mallrave	12
Grafik 7. Remitencat	13
Grafik 8. Struktura e investimeve të huaja direkte	13
Grafik 09. Vlera e asetëve e sistemit financiar të Kosovës	14
Grafik 10. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar	14
Grafik 11. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar	15
Grafik 12. Stoku i gjithsej kredive	15
Grafik 13. Kreditë e reja	16
Grafik 14. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo financiare	16
Grafik 15. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare	17
Grafik 16. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar	17
Grafik 17. Stoku i gjithsej depozitave	18
Grafik 18. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave	18
Grafik 19. Depozitat e reja	18
Grafik 20. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore	19
Grafik 21. Norma e interesit në kredi deh depozita	19
Grafik 22. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare	19
Grafik 23. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare	20
Grafik 24. Norma e interesit për depozita	20
Grafik 25. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar	20
Grafik 26. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione	21
Grafik 27. Treguesit e solvencës	21
Grafik 28. Treguesit e likuiditetit	21
Grafik 29. Asetet e sektorit pensional	24
Grafik 30. Struktura e asetëve të FKPK-së	24
Grafik 31. Struktura e asetëve të FSKP-së	25
Grafik 32. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së	25
Grafik 33. Asetet e sektorit të sigurimeve	26
Grafik 34. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara	26
Grafik 35. Asetet e sektorit mikrofinanciar	27
Grafik 36. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare	27
Grafik 37. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë	28
Grafik 38. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar	28

Grafik 39. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar -----	28
Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik -----	29
Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar-----	29
Grafik 42. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	29
Grafik 43. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore-----	30
Grafik 44. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar -----	30
Grafik 45. Shuma e ofruar dhe e emetuar -----	30
Grafik 46. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë-----	31
Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike dhe gjithsej inflacionin -----	09
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	33

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka shënuar rritje prej 5.3 përqind në vitin 2021. Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme si rezultat i përmirësimit të situatës pandemike, lehtësimit të masave të kufizuese si dhe politikës mbështetëse fiskale dhe monetare. Për dallim nga tremujori i dytë dhe tretë të vitit 2021 kur rritja reale e BPV-së vlerësohet të ketë qenë e lartë, aktiviteti ekonomik në TM4 u ngadalësua në 0.3 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, kryesisht si pasojë e përhapjes së variantit të ri të koronavirusit “Omicron” dhe rikthimit të masave në vende të ndryshme. Gjithashtu, mbi rritjen reale të ekonomisë peshou edhe rritja e çmimeve të energjisë dhe problemet ende evidente në zingjirët e furnizimit. Perspektivat për ekonominë do të varen nga rrjedha e luftës Rusi-Ukrainë dhe nga ndikimi i sanksioneve ekonomike dhe financiare dhe masave të tjera. Për shkak të këtyre pasigurive, projeksioni i fundit i BQE-së për rritjen reale të BPV-së, skenari bazë, është ulur në 3.7 përqind për vitin 2022, nga 4.2 përqind sa ishte në dhjetor 2021.

Norma mesatare e inflacionit në vitin 2021 ishte 2.6 përqind, ndërsa në TM4 2021, eurozona raportoi normën më të lartë mesatare të inflacionit të shënuar në dekadat e fundit prej 4.7 përqind. Kjo rritje e lartë e çmimeve në Eurozonë, përveç rritjes së kërkesës, i'u atribuu edhe faktorëve të përkohshëm të ndërlidhur me pandeminë, siç është rritja e kostos së inputeve si pasojë e ndërprerjes së furnizimit si dhe rritjes së kostove të energjisë. Duke marr parasysh mjedisin e pasigurt të shkaktuar nga lufta Rusi-Ukrainë, Këshilli

Drejtuës i BQE-së vendosi të reduktoj gradualisht blerjet e neto aseteve. Këto blerje të aseteve mund të përfundojnë në tremujorin e tretë, nëse të dhënat tregojnë se perspektiva për inflacionin nuk do të dobësohet. Çdo ndryshim në normat e interesit do të vijë vetëm disa kohë pas përfundimit të blerjeve neto të aseteve dhe do të jetë proces gradual. Për vitin 2022, BQE ka parashikuar normë mesatare të inflacionit prej 5.1 përqind, normë që pritet të normalizohet në dy vitet vijuese në 2.1 përkatësisht 1.9 përqind.

Aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin e kaluar. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 3.7 përqind në TM4 2021, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 4.2 përqind. Në anën tjetër, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 8.5 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 5.5 përqind.

Edhe vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizuan me rikuperim të aktivitetit ekonomik, pas goditjes së shkaktuar nga pandemia Covid-19. Në TM3 2021, aktiviteti ekonomik në këto vende u karakterizua me rritje mesatare prej 11.6 përqind. Të gjitha vendet shënuan rritje të aktivitetit ekonomik, ndërsa rritja më e lartë është shënuar në Mal të Zi (25.8 përqind) dhe Kosovë (14.5 përqind). Edhe në vendet e rajonit vërehet një ngadalësim i rritjes së aktivitetit ekonomik gjatë TM4 2021. Vlerësimet fillestare janë se aktivitetit ekonomik në Serbi ka shënuar rritje prej 7.0 përqind në TM4 ndërsa në Maqedoninë e Veriut 2.3 përqind. Vlerësimet e FMN-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik në rajon ka shënuar rritje mesatare prej 5.3 përqind në vitin 2021, ndërsa për vitin 2022, FMN ka parashikuar një rritje reale të BPV-së prej 4.4 përqind. Gjithsesi, me

pasiguritë e rritura si pasojë e luftës në Ukrainë dhe masave të ndërmarra nga BE dhe SHBA-të në formë të sanksioneve, ngjashëm me eurozonën edhe rajoni do të përballlet me ngadalësim të rritjes ekonomike.

Ngritje e shkallës së inflacionit u raportua edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, si pasojë e rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Shkalla mesatare e inflacionit në TM4 2021 ishte 5.4 përqind, ku Kosova dhe Serbia regjistruan shkallën më të lartë të rritjes së inflacionit prej 6.4 përkatësisht 7.3 përqind.

Vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 9.9 përqind. Norma më e lartë e rritjes është shënuar në Kosovë (15.5 përqind), pasuar nga Serbia (9.8 përqind), Shqipëria (9.5 përqind), Maqedonia e Veriut (8.3 përqind) dhe Mali i Zi (6.4 përqind). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 13.4 përqind, që është norma më e lartë e rritjes vitet e fundit. Tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Mal të Zi (24.6 përqind), Serbi (12.8 përqind), Kosovë (12.4 përqind), Shqipëri (9.4 përqind) dhe Maqedoni e Veriut (7.8 përqind).


Gjatë TM4 2021, euro është vlerësuar ndaj lirës turke (35.9 përqind), ka mbetur e pandryshuar ndaj dinarit serb dhe denarit maqedonas, ndërsa është zhvlerësuar ndaj sterlinës britanike (6.1 përqind), dollarit amerikan (4.1 përqind), frankës zvicerane (2.2 përqind), lekut shqiptar (1.8 përqind), kunës kroate (0.6 përqind), etj.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të konsiderueshme prej 10.5 përqind në vitin 2021 (-5.3 përqind në vitin 2020). Rritja e lartë e aktivitetit ekonomik ishte kryesisht rezultat i përmirësimit të shëndetit publik si dhe politikave stimuluese fiskale e financiare. Lehtësimi i masave kufizuese ka mbështetur lëvizjen e lirë, dinamikë që u reflektua në mbështetje shumë të lartë të aktivitetit ekonomik të gjeneruar nga diaspora. Të hyrat nga diaspora (remitencat, shpenzimet e udhëtimit dhe investimet në patundshmëri) rezultojnë të kenë pasur një pjesëmarrje të lartë në gjithsej BPV-në e gjeneruar në vend prej rreth 39 përqind në vitin 2021.

Figura 1. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK dhe llogaritjet e BQK-së.

Në TM4 2021, është shënuar rritje e aktivitetit ekonomik prej 6.4 përqind. Konsumi dhe investimet vlerësohen të kenë kontribuar pozitivisht me 8.6 përkatësisht 0.3 pikë përqindje, ndërsa eksportet neto kishin një kontribut negativ prej 2.6 pikë përqindje (grafik 1).

Sipas ASK-së, rritja më e lartë e BPV-së në TM4 2021 është shënuar në sektorin e hoteleve dhe restoranteve (25.0 përqind), tregtisë (13.7 përqind), transportit dhe magazinimit (12.2 përqind), industrisë përpunuese (8.8 përqind), etj. Në anën tjetër, në sektorin e furnizimit me energji elektrike dhe atë të ndërtimitarisë është shënuar rënie prej 13.2 përkatësisht 5.2 përqind.

Sa i përket vitit 2022, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se aktiviteti ekonomik do të shënojë rritje më të ngadalësuar prej rreth 3.3 përqind. Ngadalësimi i rritjes së aktivitetit ekonomik pritet të jetë kryesisht pasojë e rritjes më të ulët të kërkesës së brendshme, si dhe rritjes së deficitit të eksporteve neto. Lufta në Ukrainë ka ndikuar në rritjen e rreziqeve për perspektivën ekonomike dhe ndikimi i kësaj krize pritet të reflektohet në rritje të mëtejme potenciale të çmimeve të energjisë, naftës dhe ushqimit, me efekte negative në besueshmërinë e konsumatorëve dhe fuqinë blerëse. Nën supozimin se kriza gjeopolitike nuk përmbillet shpejtë dhe materjalizohen skenarët më të rënduar ku shkalla e inflacionit rritet tutje në vlera dyshifrore, perspektiva ekonomike për Kosovën do të jetë më pesimiste se pritjet fillestare.


Çmimet

Presionet inflacioniste që shoqëruan si ekonominë globale, ashtu edhe eurozonën dhe vendet e rajonit përgjatë vitit 2021, u reflektuan edhe në ekonominë e vendit. Rritja e kërkesës së përgjithshme si rezultat i rikuperimit ekonomik, shoqëruar me presionet e jashtme inflacioniste si pasojë e rritjes së çmimeve të energjisë dhe çmimeve të mallrave të importuara nga vendet partnere ndikuan që Kosova të raportoj rritje të çmimeve të përgjithshme në vend, matur përmes katër

indekseve që përpilohen nga ASK. Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje prej 3.4 përqind në vitin 2021, pasuar nga indeksi i çmimeve të prodhimit që shënoi rritje prej 4.9 përqind, indeksi i kostos së ndërtimit për 10.9 përqind, si dhe indeksi i çmimeve të importit rritje për 11.1 përqind.

Rritja më e lartë e çmimeve të konsumit është evidentuar në TM4 2021, kur është shënuar normë mesatare e inflacionit prej 6.4 përqind (grafik 2).

Figura 2. Inflacioni i përgjithshëm, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së.

Rritje më e lartë e çmimeve gjatë këtij tremujori është shënuar tek transporti, mjetet e komunikimit, ushqimi dhe pijet joalkoolike, rryma, gazi dhe lëndët tjera djegëse, etj. Në anën tjetër, vetëm çmimet e veshmbathjes kanë shënuar rënie të çmimeve (tabela 1). Struktura e shportës së konsumatorit kosovar dominohet nga kategoria e ushqimit dhe pijeve joalkoolike (39.9 përqind), si dhe kategoria e shpenzimeve të transportit (15.8 përqind). Këto kategori rezultojnë të kenë kontribuar në rritjen e përgjithshme të të çmimeve për 2.6 përkatësisht 2.2 pikë përqindje.

Tabela 1. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin gjatë TM4 2021

Përshkrimi	Peshat 2021	Norma e inflacionit	Kontributi
<i>GJITHSEJ</i>	100.0%	6.4	6.4
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	39.9%	6.3	2.6
Pijet alkoolike dhe duhani	6.4%	3.7	0.3
Veshmbathja	4.2%	-0.2	0.0
Strehimi, uji, energjia elektrike	7.8%	4.2	0.3
Orenditë	7.7%	2.4	0.2
Shëndetësia	2.1%	1.1	0.0
Transporti	15.8%	15.1	2.2
Komunikimi	3.3%	10.7	0.3
Rekreacioni dhe kultura	4.2%	1.4	0.1
Arsimi	1.0%	1.6	0.0
Hoteleria	3.1%	4.3	0.1
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.6%	2.3	0.3

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike shënuan rritje për 6.3 përqind. Në kuadër të kategorisë së ushqimit, rritje më të theksuar shënuan çmimet e vajrave dhe yndyrave (30.5 përqind), pasuar nga çmimet e bukës dhe drithërave (11.1 përqind), perimeve (9.1 përqind), si dhe qumështit, djathit dhe vezëve (6.9 përqind), ndërsa vetëm çmimet e pemëve shënuan rënie prej 3.8 përqind në TM4 2021.

Sipas Bankës Botërore, çmimet e naftës (brent crude) arritën në nivelin mesatar prej 78.3 dollar për barel në TM4 2021, që tregon për një rritje vjetore të çmimit prej 79.4 përqind. Për shkak të rritjes së çmimit të derivateve të naftës, shpenzimet e transportit shënuan rritje prej 15.1 përqind në TM4 2021. Rritja më e lartë e çmimeve të transportit është shënuar tek përdorimi i pajisjeve për transportin personal (25.8 përqind), pastaj blerja e automjeteve (5.2 përqind), si dhe shërbimet për transport (1.9 përqind).

Çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse deri në shtator 2021 shënuan rënie prej 1.2 përqind, ndërsa në TM4 2021 shënuan rritje prej 5.9 përqind. Kjo rritje

e çmimeve të energjisë në TM4 2021 është rezultat i krizës energjetike, e shkaktuar nga çmimet e larta të energjisë në tregun ndërkombëtar por edhe rritjes së konsumit gjatë muajve të dimrit, pasi që një pjesë e madhe e energjisë përdoret për ngrohje.

Trendi i përshpejtuar i rritjes së çmimeve pritet të vazhdoj edhe në vitin 2022 dhe sipas parashikimeve të BQK-së, shkalla mesatare e inflacionit për këtë vit pritet të jetë 6.4 përqind. Të ngjashme me parashikimet e BQK-së janë edhe pritjet e bankave, të cilat kanë deklaruar se presin që niveli i inflacionit do të jetë më i lartë këtë vit krahasuar me vitin e kaluar. Sidoqoftë, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit, pas invadimit të Rusisë në Ukrainë, niveli i inflacionit mund të jetë edhe më i lartë.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore¹ në vitin 2021 shënuan rritje prej 27.1 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore² shënuan rritje prej vetëm 2.3 përqind duke bërë që deficitin buxhetor të jetë mjaft i ulët. Në vitin 2021 niveli i deficitit primar buxhetor ishte 67.9 milionë euro përderisa në vitin 2020 ky nivel i deficitit ishte 485.3 milionë euro. Vetëm në TM4 2021, të hyrat buxhetore arritën vlerën neto 575.2 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.9 përqind, përderisa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 0.7 përqind dhe arritën vlerën 794.2 milionë euro. Rrjedhimisht, Buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 219.0 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Rikuperimi i aktivitetit ekonomik rezultoi në rritje të konsiderueshme të të hyrave tatimore direkte prej 15.8 përqind në TM4 2021.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen pranimet nga financimi.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat për financim.

Tatimi në të ardhurat e korporatave shënoi rritje prej 33.2 përqind, ndërsa tatimi në të ardhurat personale, si kategoria kryesore e të hyrave tatimore direkte, shënoi rritje prej 12.1 përqind. Me rritjen e kërkesës së brendshme, e cila ka ndikuar në rritjen e importit të mallrave, është shënuar rritje prej 21.6 përqind edhe në të hyrat tatimore indirekte, të cilat dominojnë të hyrat buxhetore me rreth 78 përqind. Në TM4 2021, të hyrat tatimore indirekte shënuan vlerën 447.7 milionë euro, ku TVSH-ja dhe akciza si dy kategoritë kryesore të tatimeve indirekte shënuan rritje prej 24.4 përkatësisht 17.7 përqind.

Sa i përket shpenzimeve, kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e shpenzimeve buxhetore ishin shpenzimeve kapitale, të cilat arritën vlerën prej 199.0 milionë euro apo 13.4 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020. Në anën tjetër, shpenzimet rrjedhëse shënuan rënie prej 2.9 përqind dhe arritën vlerën 595.2 milionë euro. Në kuadër të shpenzimeve rrjedhëse, subvencionet dhe transferet shënuan rënie prej 6.3 përqind dhe arritën vlerën 301.8 milionë euro. Shpenzimet për paga shënuan rënie prej 2.1 përqind dhe arritën vlerën 166.8 milionë euro, ndërsa shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rritje prej 4.7 përqind dhe arritën vlerën 126.5 milionë euro.

Borxhi publik në TM4 2021 ka arritur në 1.68 miliardë euro, që është për 13.1 përqind më i lartë krahasuar me TM4 2020. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 23.3 përqind nga 22.4 përqind sa ishte në TM4 2020. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik për 15.0 përqind (që ka arritur në 1.11 miliardë euro), si dhe rritjes së borxhit të jashtëm publik prej 9.6 përqind (që ka arritur në


576.4 milionë euro). Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik prej 23.3 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës.

Sektori i Jashtëm

Aktiviteti i gjeneruar në kuadër të sektorit të jashtëm rezulton të ketë pasur peshën kryesore në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend në vitin 2021. Rritja e të hyrave nga diaspora, përmes kanaleve kryesore si remitencat, shpenzimet e udhëtimit dhe blerja e patundshmërive u përkthyen në rritje të kërkesës së përgjithshme në vend duke mbështetur si rritjen e konsumit, ashtu edhe të investimeve në vitin 2021. Rritja e kërkesës së brendshme rezultoi në rritje të importeve, gjë që përkeqësoi bilancin e mallrave, përkundër rritjes që shënuan eksportet.

Në vitin 2021 deficitin e llogarisë rrjedhëse ka shënuar rritje prej 46.4 përqind duke arritur në 691.2 milionë euro. Si pjesëmarrje e BPV-së, deficitin e llogarisë rrjedhëse në vitin 2021 arriti në 8.9 përqind nga 7.0 përqind në vitin 2020. Vetëm në TM4 2021, është shënuar rritje e deficitit prej 150.8 përqind duke arritur në 392.8 milionë euro (grafik 3). Ky përkeqësim i bilancit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së deficitit të mallrave dhe zvogëlimit të bilancit të të ardhurave dytësore, ndërkohë që bilanci i shërbimeve dhe ai i të ardhurave parësore është përmirësuar.

Figura 3. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro



Burimi: BQK.

Eksporti i mallrave në TM4 2021 ka shënuar rritje për 46.1 përqind ndërsa importi i mallrave është rritur për 36.3 përqind. Përkundër normës më të lartë të rritjes së eksportit, niveli dukshëm më i lartë i importit ka ndikuar që deficiti tregtar i mallrave të rritet për 34.4 përqind duke arritur nivelin prej 1.0 miliardë euro (grafik 4).


Figura 4. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Vlera e eksportit të mallrave gjatë TM4 2021 ishte 209.8 milionë euro dhe pothuajse të gjitha kategoritë e eksportit shënuan rritje, ndërsa rritja më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020, është shënuar tek produktet e plastikës, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, pastaj produktet minerale, metalet bazë, etj. (grafik 5).

Figura 5. Kategoritë kryesore të eksportit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.


Pothuajse të gjitha këto kategori kanë shënuar rritje të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e metaleve bazë në TM4 2021 shënuan rritje prej 37.9 përqind dhe kjo ka ndikuar në rritjen e eksportit të metaleve bazë për 6.2 përqind. Gjithashtu, edhe indeksi i çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare por edhe ai i çmimeve të ushqimit ka shënuar rritje prej 106.3 përkatesisht 20.6 përqind ndërkohë që rritja e eksportit të mineraleve dhe ushqimeve të përgatitura ishte 60.1 përkatesisht 36.4 përqind në TM4 2021.

Vendet e CEFTA-s dhe vendet e BE-së përfaqësojnë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës për eksporte, me pjesëmarrje prej 34.3 përkatesisht 28.5 përqind të gjithsej eksporteve në TM4 2021. Eksportet drejt vendeve të CEFTA-s vetëm në TM4 2021 ishin 71.6 milionë euro, një rritje prej 16.4 përqind, ndërsa eksporti i mallrave në vendet e BE-së ishte 59.4 milionë euro apo 27.1 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020. Eksportet drejt SHBA-së kanë vazhduar të karakterizohen me një trend të lartë rritës. Në TM4 2021, niveli i eksportit të mallrave drejt SHBA-së ishte 45.9 milionë euro (10.6 milionë euro në TM4 2020),

duke bërë që pjesëmarrja e SHBA-ve në gjithsej eksportin e mallrave të arrij në 22.0 përqind nga vetëm 7.4 përqind në TM4 2020.

Vlera e importit të mallrave gjatë TM4 2021 ishte 1.2 miliardë euro, që paraqet rritje prej 36.3 përqind. Pothuajse të gjitha kategoritë e importit kanë shënuar rritje, ndërkohë që rritjen më të lartë e ka shënuar importi i produkteve minerale, pastaj metalet bazë, makineritë dhe pajisjet elektrike, ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, etj. (grafik 6).

Figura 6. Kategoritë kryesore të importit të mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK.

Edhe tek importi i mallrave, përveç rritjes së kërkesës vendore, ka ndikuar edhe rritja e lartë e çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e naftës së papërpunuar janë rritur për 79.4 përqind në TM4 2021, ndërkohë që importi i produkteve minerale, si njëra ndër kategoritë kryesore të importit të mallrave, është rritur për 83.9 përqind.

Sa i përket importit sipas vendeve, vendet e BE-së dhe vendet anëtare të CEFTA-s janë vendet prej nga Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave. Në TM4 2021, Kosova importoi 43.7 përqind të gjithsej mallrave nga vendet e BE-së apo 31.7 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020, si dhe 19.3 përqind të

gjithsej importeve nga vendet e CEFTA-s apo 26.2 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020. Një pjesë e madhe e importit të mallrave është realizuar edhe nga Turqia dhe Kina. Importi i mallrave nga Turqia ishte 12.9 përqind e gjithsej importit apo 42.7 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020, ndërsa importi i mallrave nga Kina, kishte një pjesëmarrje prej 10.4 përqind në gjithsej importin e mallrave apo 33.5 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020.


Me zbutjen dhe eliminimin e masave kufizuese, edhe tregtia me shërbime ka shënuar rritje të përshpejtuar në vitin 2021. Në TM4 2021, bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 139.2 milionë euro, nga 95.2 milionë euro sa ishte në TM4 2020.

Vlera e eksportit të shërbimeve arriti në 354.2 milionë euro, nga 261.6 milionë euro sa ishte në TM4 2020. Rritjen më të lartë e shënuan eksporti i shërbimeve të udhëtimit dhe transportit, ku si rezultat i numrit më të madh të diasporës që e vizituan Kosovën, eksporti i shërbimeve të udhëtimit vetëm në këtë tremujor arriti vlerën prej 219.2 milionë euro (157.8 milionë euro në TM4 2020). Edhe importi i shërbimeve ka shënuar rritje në TM4 2021, ku vlera e shërbimeve të importuara ishte 214.9 milionë euro (166.4 milionë euro në TM4 2020). Edhe tek importi, rritja më e lartë është shënuar tek importi i shërbimeve të udhëtimit dhe transportit. Vlen të theksohet se eksporti dhe importi i shërbimeve ishte më i lartë edhe krahasuar me TM4 2019 për 34.5 përkatësisht 24.7 përqind.

Llogaria e të ardhurave parësore shënoi rritje për 125.6 përqind në TM4 2021, pasi që të ardhurat nga investimet në Kosovë ishin më të ulëta, ndërsa të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve jashtë Kosovës

ishin më të larta. Norma e lartë e rritjes së remitencave në vitin 2020, përkundër situatës së vështirë të krijuar nga pandemia Covid-19, ka vazhduar edhe në vitin 2021. Gjatë vitit 2021 niveli i remitencave ka arritur në 1.15 miliardë euro apo 17.1 përqind më shumë krahasuar me vitin 2020. Për dallim nga tremujorët paraprak kur ishte shënuar rritje e lartë e remitencave, në TM4 2021 është shënuar një ngadalësim i rritjes së tyre. Gjatë TM4 2021 niveli i remitencave ishte 285.9 milionë euro apo 1.0 përqind më shumë krahasuar me TM4 2020 (grafik 7).

Figura 7. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK.

Sa i përket kanaleve të transferimit, më shumë se gjysma e remitencave (57.9 përqind) kanë ardhur përmes agjencive për transferim të mjeteve por që në TM4 2021 shënuan rënie prej 4.9 përqind. Remitencat përmes bankave shënuan rritje prej 14.7 përqind dhe përbëjnë 15.6 përqind të gjithsej remitencave të pranuar në TM4 2021. Si rezultat i hapjes së kufijve dhe relaksimit të masave edhe remitencat përmes kanalit 'jo-formal' janë rritur për 7.9 përqind dhe kanë arritur nivelin prej 75.6 milionë euro në TM4 2021. Remitencat në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, me 40.0 përkatësisht 18.6 përqind të gjithsej remitencave deri në shtator të vitit 2021. Një

pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të (7.3 përqind e gjithsej remitencave).

Figura 8. Struktura e investimeve të huaja direkte, në milionë euro



Burimi: BQK.


Investimet e Huaja Direkte (IHD) gjatë vitit 2021 kanë arritur vlerën prej 421.0 milionë euro apo 21.8 përqind më shumë krahasuar me vitin 2020. Për dallim nga tremujorët paraprak kur ishte shënuar rritje e lartë e IHD-ve, në TM4 2021 është shënuar nivel më i ulët, kryesisht për shkak të shpërndarjes së dividendës. Gjatë TM4 2021 niveli i IHD-ve ishte 34.3 milionë euro apo 62.5 përqind më pak krahasuar me TM4 2020. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, kapitali dhe fondi i investimeve në aksione ishte 35.9 milionë euro, ndërsa instrumentet e borxhit shënuan rënie për 1.7 milionë euro (grafik 8).

Rënia e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të furnizimit me energji elektrike, etj., ndërsa në sektorin e aktiviteteve të patundshmërisë, ndërtimtarisë, etj. është shënuar rritje e IHD-ve.

Sistemi Financiar

Sistemi financiar u karakterizua me rritje të aktivitetit në të gjitha segmentet përbërëse të tij. Masat e ndërmarra nga BQK në formë të moratoriumit dhe rishtruktiveve, sentimentit pozitiv në akterët kryesor në treg, indikatorët e shëndetit të sektorit bankar dhe rritja e kërkesës së përgjithshme në vend rezultuan në rritje të kreditimit, duke mbështetur kështu rikuperimin e ekonomisë së vendit. Edhe kontributi i segmenteve tjera në rritjen e aseteve të sistemit financiar, veçanërisht sistemit pensional, ishte pozitiv gjatë vitit 2021, mbështetur në performancën e përgjithshme pozitive ekonomike.

Grafik 09. Vlera e aseteve e sistemit financiar të Kosovës




Burimi: BQK.

Në fund të dhjetorit 2021, asetet e sistemit financiar arritën vlerën prej 8.93 miliardë euro, e që paraqet një rritje vjetore prej 12.7 përqind (grafik 09).

Rritja dyshifrore e aseteve të sistemit financiar kryesisht reflekton rritjen e aseteve të sektorit bankar si rezultat i rritjes së nivelit të depozitave, si dhe kthimin më të lartë në investime dhe arkëtimet e reja prej kontribut-dhënësve në kadër të sektorit pensional.

Sektori bankar vazhdon të ketë peshën kryesore në kuadër të sistemit financiar dhe përbën një ndër burimet kryesore financuese për bizneset dhe ekonominë familjare (grafik 10). Sektori pensional përfaqëson 26.5 përqind të tregut financiar në vend, pasuar nga institucionet mikrofinanciare, sigurimet dhe ndihmësit financiar.

Grafik 10. Koncentrimi në asetet e sistemit financiar, sipas sektorëve përbërës



Burimi: BQK.

1. Sektori Bankar


Sektori bankar gjatë vitit 2021 u karakterizua me nivel optimal të kapitalizimit, likuditetit si dhe cilësi të lartë të portfolios kreditore, megjithë krizën evidente pandemike (Covid-19). Për më tepër, sektori bankar arriti të relizoj fitim në vlerë rekorde dhe u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aktivitetit kreditues dhe rritje dyshifrore të depozitave.

1.1. Bilanci i gjendjes - Asetet

Asetet e sektori bankar janë karakterizuar me rritje vjetore dyshifrore në tri vitet e fundit, financiar kryesisht përmes depozitave të arkëtuara. Në dhjetor 2021, gjithsej asetet e sektorit bankar arritën vlerën në

5.96 miliard euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.1 përqind (grafik 11). Struktura e asetëve vazhdon të mbetet e ngjashme me vitet paraprake, me kreditë që kanë peshën më të madhe në kuadër të asetëve (62.9 përqind), pasuar nga ajo e parasë së gatshme (14.1 përqind), letrave me vlerë (11.5 përqind), dhe mjeteve të mbajtura në bankat tjera komerciale (11.1 përqind) e që kryesisht janë jashtë vendit.

Grafik 11. Bilanci i gjendjes të sektorit bankar - asetet




Burimi: BQK.

Në dy vitet e fundit, struktura e investimeve të letrave me vlerë rezultoi të ketë ndryshuar dhe të jetë orientuar kryesisht nga investimet në letra me vlerë jo-qeveritare, të cilat bartin rrezik më të lartë por edhe kthim më të lartë në investime. Pështja e tyre ka arritur në 10.3 përqind të gjithsej letrave me vlerë, krahasuar me 5.4 përqind sa ishte dy vite më parë (dhjetor 2019). Ndryshimi në strukturën e letrave me vlerë në dy vitet e fundit kryesisht reflektoi shkallën e lartë të likuiditetit në sektorin bankar, si kthimin më të lartë në investime nga letrat me vlerë jo-qeveritare. Mjetet e mbajtura në bankat tjera janë kryesisht në formë të llogarisë rrjedhëse dhe atë të afatizuar, të cilat shfrytëzohen edhe për të kryer transaksione ndërkombëtare të klientëve të bankave.

1.1.1 Aktiviteti kredidhënës

Aktiviteti kredidhënës shënoi rritje të përsheptuar krahasuar me vitin e kaluar, duke vazhduar trendin e rritjes dyshifrore të para pandemisë (Covid-19) (grafik 12). Në dhjetor 2021, gjithsej kreditë arritën në 3.75 miliard euro, një rritje vjetore 15.5 përqind (7.1 përqind në periudhën paraprake). Në këtë rritje kontribuuan si sektori i ekonomive familjare, që shënoi rritjen më të lartë, ashtu edhe sektori i korporatave jofinanciare, që njëherësh kishte kontributin kryesor në rritjen e gjithsej kredive.

Grafik 12. Stoku i gjithsej kredive, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Rritja e përsheptuar e kreditimit ndaj ekonomive familjare dhe sektorit të ndërmarrjeve kryesisht i është atribuar rritjes së ofertës kreditore nga bankat, mbështetur në prospektet pozitive makroekonomike me rikuperimin ekonomik. Po ashtu, edhe niveli i lartë i kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe ciësia e mirë e portfolios kreditore megjithë shkallën e lartë të ristrukturimeve, ndikuan në apetitet e bankave për rritje të kreditimit në vend. Kreditimi u mbështet edhe nga rritja e kërkesës për kredi, që kryesisht u mbështet nga rritja e përgjithshme e kërkesës së brendshme dhe të hyrave të përgjithshme në ekonomi (të hyrave me bazë nga diaspora).

Edhe kreditë e reja rikuperuan ecurinë e rritjes në vitin 2021, pas vitit pandemik kur shënuan tkurrje (grafik 13). Rritja më e lartë në kuadër të kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar është evidentuar tek sektori i ekonomive familjare, kreditimi ndaj të cilave u rrit për 45.0 përqind (-2.4 përqind në vitin 2020). Kontributin kryesor në rritjen e kredive të reja ndaj ekonomive familjare vazhdojnë të kenë ato për qëllime konsumi, që shënuan rritje vjetore prej 40.3 përqind (-4.0 përqind në periudhën paraprake) – dhe kanë një pjesëmarrje prej 68.3 përqind në gjithsej kreditë për këtë segment. Kurse, kreditë e reja hipotekare, që kanë një pjesëmarrje prej 24.8 përqind në gjithsej kreditë e reja ndaj sektorit të ekonomive familjare, shënuan rritjen më të lartë gjatë kësaj periudhe prej 56.5 përqind (12.7 përqind në periudhën paraprake).

Grafik 13. Kreditë e reja, ndryshimi vjetor




Burimi: BQK.

Në rritje të theksuar të kredive hipotekare ka ndikuar ofrimi i kushteve më të favorshme nga bankat për këtë kategori, përmes normës së ulët të interesit dhe zgjatjes së afatit të maturitetit. Për më tepër, fillimi i pajisjes me dokumentacion të rregullt të patundshmërive ka ndikuar që bankat të kenë fokus më të lartë në dhënie të kredive rezidenciale, kundrejt

kolateralit të patundshmërisë. Rritja e kredive të reja konsumuese në anën tjetër mund t'i atribuohet rritjes së përgjithshme të konsumit në vend, rritjes së remitencave (atyre formale dh joformale) si dhe nivelit të ulët të kredive me probleme për këtë segment.

Kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare, që kanë peshën më të madhe në gjithsej kreditë e lëshuara (prej 57.2 përqind), u rritën për 10.4 përqind gjatë kësaj periudhe (rritje për 4.4 përqind në vitin 2020). Në këtë rritje ndikimin më të lartë kishte ecuria e kredive të reja me qëllim jo-investues (rritje për 41.9 përqind), kurse kreditë me qëllim investues vazhdojnë të kenë peshën më të madhe në gjithsej kreditimin ndaj korporatave jofinanciare prej 54.7 përqind. Kreditë e reja investuese shënuan rënie vjetore për 6.6 përqind (rritje për 15.3 përqind në vitin 2020).

Grafik 14. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

Stoku i kredive ndaj korporatave jofinanciare vazhdon të dominohet prej sektorit të tregtisë, pasuar nga ai i prodhimitarisë, përderisa sektori i bujqësisë vazhdon të ketë peshën më të ulët (grafik 14).

Kreditë ndaj sektorit të tregtisë u rritën për 9.6 përqind (12.2 përqind në vitin 2020) dhe kishin kontributin më të lartë në rritjen e gjithsej kreditimit

të korporatave jofinanciare. Kurse, kreditimi ndaj sektorit të prodhimitarisë shënoi rriten më të lartë gjatë kësaj periudhe. Kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë shënoi rënie, por e cila ishte më e ulët krahasuar me rënien e një viti më parë. (grafik 15).

Grafik 15. Ndryshimi vjetor në kreditë ndaj korporatave jofinanciare, sipas veprimtarisë ekonomike



Burimi: BQK.

Kreditë në ristrukturim në fund të dhjetorit 2021 përfaqësuan 19.0 përqind të stokut të kredive, prej të cilave 12.9 përqind i përkisnin fazës së parë të ristrukturimit³, 5.8 përqind fazës së dytë⁴ dhe 0.3 përqind fazës së tretë⁵. Në fazën e parë, vlera e kredive të ristrukturuara arriti në 1.30 miliardë euro, kurse në fund të dhjetorit 2021, zbriti në 694 milionë euro⁶, prej të cilave 190.6 milionë euro janë ristrukturime ndaj ekonomive familjare, kurse pjesa tjetër për korporatat jofinanciare. Kreditë në ristrukturim pritet të maturojnë në fund të muajit shkurt të vitit 2022, kur dhe pritet të shihet konkretisht performanca e kësaj portfolio.


Në dhjetor 2021, nga gjithsej kreditë aktive që kanë qenë në ristrukturim, rreth 71.4 përqind rezultuan

ishin të kategorizuara në shtyllën e parë, 23.4 përqind në shtyllën e dytë, dhe 5.2 përqind në shtyllën e tretë (kredi jo-performuese).

1.2 Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar vazhdon të jetë tradicionale dhe përbëhet kryesisht nga depozitat (82.3 përqind), burimet vetanake (10.8 përqind), dhe obligimeve tjera (3.7 përqind). Historikisht, depozitat kanë paraqitur një burim të sigurt financues dhe me kosto mjaftë të ulët për sektorin.

Grafik 16. Bilanci i gjendjes i sektorit bankar - detyrimet dhe ekuiteti



Burimi: BQK.

1.2.1 Depozitat


Vlera e depozitave të mbajtura nga sektori bankar në fund të vitit 2021 arriti në 4.90 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 12.4 përqind (grafik 17 dhe 18).

Depozitat e arkëtuara prej ekonomive familjare vazhdojnë të kenë kontributin kryesor në rritje të

³ Faza e parë e ristrukturimit filloi në Mars 2020, faza e dytë e ristrukturimit filloi në Qershor 2020, faza e tretë në shkurt 2021. dhe nivelin më të lartë arriti në Nëntor 2020 prej 12.0 përqind të gjithsej stokut të kredive aktive. dhe nivelin më të lartë e kishte në Maj 2020 prej 42.2 përqind të gjithsej stokut të kredive aktive

gjithsej depozitave, pasuar nga depozitat e arkëtuara prej korporatave jofinanciare.


Grafik 17. Stoku i gjithsej depozitave



Burimi: BQK.

Depozitat e korporatave tjera financiare (kryesisht fondet pensionale) shënuan rënie, kryesisht për shkak të ri-alokimit të mjeteve në sektorin e jashtëm.

Grafik 18. Kontributi në rritjen vjetore të gjithsej depozitave, pikë përqindje




Burimi: BQK.

Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 68.7 përqind të gjithsej depozitave, shënuan rritje vjetore prej 14.6 përqind (12.9 përqind në vitin 2020), kryesisht si rezultat i fluksit më të lartë të ardhjes së diasporës - remitanca të pranuar në kanale formale

dhe joformale, si dhe i probabilitetit më të lartë të kursimit në kohë pasigurie kundrejtë shpenzimit.

Grafik 19. Depozitat e reja, ndryshimi vjetor



Burimi: BQK.

Edhe niveli i depozitave të mbajtura në sektorin bankar prej korporatave jofinanciare shënoi rritje gjatë kësaj periudhe (19.3 përqind), e që mund të reflektoj deri në një masë edhe pasigurinë e një pjese të bizneseve për të bërë investime kapitale, veçanërisht bizneseve në sektorët që kanë rezultuar më të ndikuar nga kriza pandemike.


Në vitin 2021, vlera e depozitave të reja të arkëtuara⁷ arriti në 446.1 milionë euro, që është për 5.3 përqind përqind më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (grafik 19). Vlera e ulët e depozitave të reja të arkëtuara në vitet e fundit reflekton nivelin e ulët të normave të interesit për depozitat e afatizuara⁸, struktura e të cilave në vitet e fundit është tkurrur kundrejt rritjes së atyre të transferueshme (grafik 20). Depozitat e reja të arkëtuara nga korporatat jofinanciare (depozitat e afatizuara) gjatë kësaj periudhe shënuan vlerën prej 106.2 milionë euro, një rënie për 29.4 përqind. Kurse, depozitat e reja të

⁷ Depozitat e reja përfshijnë depozitat e afatizuara.

⁸ Norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara në sektorin bankar gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 ishte 1.3 përqind.

arkëtuara nga ekonomitë familjare (depozitat e afatizuara), arritën vlerën prej 339.9 milionë euro në vitin 2021, që paraqet një rritje vjetore prej 6.0 përqind.

Grafik 20. Struktura e depozitave sipas kategorive kryesore




Burimi: BQK.

1.3 Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi kanë shënuar rënie graduale ndër vite, duke arritur në nivel të përafërt me vendet e rajonit. Kurse, norma mesatare e interesit në depozita ka mbetur pothuajse e pandryshuar në vitet e fundit, që kryesisht ka reflektuar nivelin e lartë të likuiditetit të bankave.

Grafik 21. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK.

Në dhjetor 2021, norma e interesit në kredi ishte 5.8 përqind kurse ajo për depozita në 1.3 përqind, duke ngushtuar marginën e kredidepozitave në 4.5 pikë përqindje (grafik 21).

1.3.1 Normat e interesit në kredi

Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare deri në një masë janë më të favorshme krahasuar me ato ndaj ekonomive familjare (grafik 22). Në dhjetor 2021, norma e interesit për kreditë ndaj korporatave jofinanciare qëndroi në 5.7 përqind (5.9 përqind në dhjetor 2020) (grafik 22).

Grafik 22. Norma e interesit në kredi për korporatat jofinanciare



Burimi: BQK.


Normat e interesit në kreditë ndaj sektorit të shërbimeve dhe të industrisë janë më të favorshme krahasuar me ato për sektorin e bujqësisë.

Normat më të larta të interesit në kredi për sektorin e bujqësisë janë rezultat i rrezikut më të lartë që mbartë ky sektor, megjithëse në vitet e fundit është evidentuar rënie e kostos së financimit edhe për këtë sektor (grafik 22).

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare vazhduan trendin rënës ngjashëm me ato të korporatave jofinanciare. Norma e interesit për këtë segment në dhjetor 2021 qëndroi në 6.0 përqind.

Normë më të favorshme të interesit kishin kreditë hipotekare – që reflekton dhe rritjen e lartë të kredive të reja hipotekare përgjatë vitit 2021. Ndërsa, normat e interesit për kreditë konsumuese ishin më të larta se sa mesatarja e segmentit, por krahasuar me periudhat paraprake, kemi poashtu rënie të konsiderueshme (grafik 23).

Grafik 23. Norma e interesit në kredi për ekonomitë familjare




Burimi: BQK.

1.3.2 Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të ulëta, me norma më të favorshme për korporatat jofinanciare (2.0 përqind) krahasuar me ato për ekonomitë familjare (0.9 përqind) (grafik 24).

Grafik 24. Normat e interesit për depozita




Burimi: BQK.

Performanca e sektorit bankar

Sektori bankar deri në dhjetor 2021 realizoi fitim në vlerë prej 117.5 milionë euro, e që është për 37.6 milionë euro më i lartë krahasuar me gjendjen në fund të dhjetorit 2020 (grafik 25). Fitimi më i lartë i realizuar këtë periudhë reflekton ecurinë e të hyrave (të cilat u rritën për 15.4 përqind) dhe shpenzimeve (të cilat shënuan rritje marginale për 2.6 përqind).

Në kuadër të hyrave, të hyrat nga interesi janë kategoria me peshën më të madhe (70.4 përqind) dhe shënuan rritje vjetore prej 6.9 përqind, rritje kryesisht e atribuar të ardhurave nga interesi në kredi. Të hyrat nga jointerеси që kanë peshë më të ulët në gjithsej të hyrat e sektorit (26.7 përqind) kishin kontributin më të lartë në rritje të të ardhurave të sektorit, pasi që shënuan rritje për 31.0 përqind. Nënkatëgoria e cila shënoi rritjen më të lartë ishte ajo e tarifave dhe komisioneve, e që reflekton rritjen e kostos për ofrimin e shërbimeve bankare si dhe shfrytëzimin më të lartë të atyre e-banking.

Grafik 25. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK.


Në kuadër të shpenzimeve, kategoria e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative që ka peshën më të madhe në gjithsej shpenzimet (58.9 përqind) shënoi

rritje vjetore prej 11.6 përqind gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, kategoria e dytë me peshën më të madhe, ajo e shpenzimeve të jointeredit (22.6 përqind), shënoi rënie vjetore prej 24.5 përqind si pasojë e rënies së shpenzimeve për provizionimin nga humbjet e mundshme në kredi. Kjo nënkategori kishte dhe kontributin më të lartë në ngadalësimin e theksuar të rritjes së gjithsej shpenzimeve këtë vit. Kategoria e shpenzimeve për interesa përfaqëson vetëm 11.9 përqind të gjithsej shpenzimeve dhe shënoi rritje vjetore prej 16.9 përqind këtë periudhë, kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve tjera nga interesi.

Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar ka trashëguar nga vitet e kaluara nivel të lartë të kapitalizimit, likuiditetit dhe portfolio me cilësi të lartë kreditore.


Grafik 26. Kreditë joperformuese dhe mbulueshmëria me provizione



Burimi: BQK.

Kjo ka ndikuar që sektori të ketë kapacitet për të absorbuar krizën e shkaktuar nga pandemia Covid-19 në vitin 2020, duke ruajtur nivel të mirë të treguesve kryesor të shëndetit bankar.


Grafik 27. Treguesi i solvencës



Burimi: BQK.

Niveli i kredive joperformuese në dhjetor 2021 qëndroi në 2.3 përqind, dhe mbulueshmëria me provizione nga humbjet e mundshme në 151.0 përqind (grafik 26). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit qëndroi në nivel prej 15.3 përqind, dukshëm mbi nivelin minimal me rregullore prej 12.0 përqind (grafik 27).

Grafik 28. Treguesit e likuiditetit



Burimi: BQK.

Për më tepër, edhe likuiditeti i sektorit qëndroi dukshëm mbi nivelin minimal të rekomanduar prej 25.0 përqind. Raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra në dhjetor 2021 qëndroi në nivel prej 37.4 përqind (grafik 28).

Në përgjithësi, sektori bankar vazhdon të operoj në një ambient me nivel të ulët të kredive me

probleme, likuiditet të lartë dhe është mirë i kapitalizuar. Kjo ka rezultuar që sektori të ndaj më pak shpenzime për provizione për humbjet e mundshme në kredi, nivel më të ulët të shpenzimeve për interesa. Të hyrat stabile nga


interesi dhe ato në rritje prej tarifave dhe komisioneve kanë ndikuar në rritje të fitimit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe.

Kuti informuese

Bankat me rëndësi sistematike⁹

- Në sektorin bankar, pesë bankat më të mëdha kanë rezultuar me rëndësi të përgjithshme sistematike (grafik 1)


Grafik 1. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistematike



Burimi: BQK.

- Në kriteret e veçanta, bankat e rëndësisë së përgjithshme sistematike kanë rezultuar të tilla edhe në kriteret përbërëse (përjashtuar atë të ndërlidhjes) (grafik 2).
- Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit ka nivelin më të lartë të pikëve sistematike, për shkak që qasja në financim me sektorin e jashtëm është më e limituar për bankat e vogla krahasuar me ato të mëdha. Po ashtu, vetëm disa banka shfrytëzojnë këtë të drejtë, andaj kemi koncentrim më të lartë në këtë kriter.

Grafik 2. Shkalla e rëndësisë sistematike, sipas kriterëve



Burimi: BQK.


Kapitali shtesë kundërciklik¹⁰

- Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është realizuar sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç'rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të asetëve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind.
- Hendeku kredi/BPV ishte nën pragun prej 2.0 pikë përqindje në dhjetor 2021, përkatësisht 0.990 (grafik 3), që nënkupton që sektori bankar nuk ka nevojë të ndaj kapital shtesë ndaj mjeteve të peshuara me rrezik (grafik 4).


⁹ Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistematike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull 'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistematike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

¹⁰ Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazelit.


Grafik 3. Hendeku i kreditimit



Grafik 4. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Grafik 5. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar dhe kriteve përbërëse



Rritja e evidentuar e ndjeshmërisë ndaj rrezikut u ndikua nga indikatorët e solvencës dhe indikatorët e likuiditetit. Kurse, indikatorët e rrezikut kreditor, profitabilitetit, dhe tregut u karakterizuan me ulje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut.

- Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut në indikatorin e solvencës i atribuohet kryesisht nivelit më të ulët të treguesve të kapitalit (Treguesit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit & Kapitalit të Klasit të Parë) krahasuar me gjendjen një vit më parë, e që është rezultat i ndarjes së dividendës në tetor 2021 me skadimin e masës rekomanduese nga BQK, ndërkohë që kreditimi ka shënuar rritje të shpejtë. Sektori vazhdon të tejkaloj minimumin e rekomanduar të TMK-së prej 12%.
- Rritja e ndjeshmërisë së rrezikut tek indikatorin e likuiditetit ishte kryesisht rezultat i nivelit më të ulët të likuiditetit, shprehur përmes mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra (rritje më të ulët të mjeteve likuide kundrejt rritjes më të lartë të detyrimeve afatshkurtra), si dhe ndaj gjithsej asetëve (rritje më të ulët të mjeteve likuide kundrejt total asetëve).
- Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut tek indikatorin e rrezikut kreditor ishte kryesisht rezultat i uljes në vlerë dhe nivel të KJP-ve në vitin 2021 krahasuar me vitin e kaluar.
- Rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut tek indikatorin e profitabilitetit i'u atribuua fitimit të lartë të realizuar, ndikuar nga rritja e lartë në të hyra e gjeneruara (nga interesi e veçanërisht prej tarifave dhe komisioneve) dhe ngadalësimin të thekuar të rritjes në shpenzime (kryesisht rezultat i zvogëlimit të provizioneve për humbjet e mundshme në kredi).

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar¹¹

- Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar është ndërtuar mbështetur në tregues me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, për matjen dhe vlerësimin e kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.
- Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, në mesatare, është shënuar rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut në fund të TM4 2021 krahasuar me gjenjen në fund të TM4 2020.
- Vlera e përgjithshme e indeksit në fund të TM4 2021 është nën vlerën mesatare të indeksit (grafik 5), ngjashëm me vitin 2020 (periudha më kritike për shkak të pandemisë Covid-19). Po ashtu, ky tremujor në vitin 2021 ishte i vetmi, në të cilin vlera e përgjithshme mesatare e indeksit ishte nën mestaren historike.

¹¹ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.


Sektori pensional

Rritja e shkallës së vaksinimit dhe rimëkëmbja ekonomike në nivel global ndikuan në përmirësimin e performancës së tregjeve globale, rrjedhmisht performancë pozitive financiare të fondeve pensionale në vitin 2021.

Sektori pensional, si sektori i dytë për nga pesha në sistemin financiar, përbën 26.5 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar. Asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 18.2 përqind në dhjetor 2021 dhe arritën vlerën prej 2.36 miliardë euro (grafik 29). Rritja e asetëve kryesisht reflekton rritjen e kontributeve të reja dhe kthimin e realizuar në investime në vitin 2021.

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Sllovenokosovar të Pensioneve (FSKP).

Grafik 29. Asetet e sektorit pensional




Burimi: BQK.

Struktura e asetëve të FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit, ndër vite pesha e tyre gradualisht është zvogëluar kundrejt rritjes së peshës së mjeteve të investuara në vend. Rreth 76.9 përqind e mjeteve të FKPK-së janë të mbajtura jashtë

vendit. Saktësisht, në vlera monetare, rreth 1.81 miliardë euro janë të alokuara në fonde të përbashkëta investuese dhe 1.0 milionë euro janë para në banka (tranzit) (grafik 30).

Pjesa e mbetur e mjeteve u investuan brenda vendit, dhe arritën vlerën prej 544.6 milionë euro në fund të dhjetorit 2021. Këto mjete janë kryesisht të investuara në fletë-obligacione dhe bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës, të cilat në fund të dhjetorit 2021 arritën vlerën prej 491.5 milionë euro dhe paraqet një rritje vjetore prej 9.0 përqind. Paraja e mbajtur në Bankën Qendrore të Kosovës u zvogëluar konsiderueshëm, si rrjedhojë e ri-alokimit të mjeteve në sektorin e jashtëm gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, edhe vlera e mjeteve të mbajtura nëpër bankat komerciale, në formë të Çertifikatave të Depozitit, u zvogëluar konsiderueshëm, për shkak të orientimit të strategjisë në investime jashtë vendit.

Grafik 30. Struktura e asetëve të FKPK-së (dhjetor 2021)




Burimi: FKPK.

Struktura e asetëve të FSKP-së është e ngjashme me atë të FKPK-së, ku rreth 79.3 përqind e tyre janë të investuara jashtë vendit, dhe pjesa e mbetur në Kosovë. Portfolio e FSKP-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (69.1 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (19.6

përqind), paraja e gatshme (4.3 përqind) dhe instrumentet tjera (7.0 përqind) (grafik 31). Gjithsej asetet e FSKP-së deri në dhjetor 2021 arritën në 9.5 milionë euro, e që paraqet rritje vjetore prej 11.1 përqind.

Grafik 31. Struktura e aseteve të FSKP-së (dhjetor 2021)




Burimi: FSKP.

Rritja e aseteve të FSKP-së reflekton rritjen vjetore të konsiderueshme të investimeve jashtë vendit në aksione, saktësisht prej 19.1 përqind.

Gjatë vitit 2021, FSKP-ja kishte kthim bruto në investime në vlerë prej 1.01 milionë euro (388.8 mijë euro një vit më parë). Ndërsa, vlera e arkëtimeve të reja nga kontribut-dhënësit në vitin 2021 arriti në 546.4 mijë euro (554.1 mijë euro).

Grafik 32. Kthimi në investime dhe performanca e FSKP-së



Burimi: FSKP.

Kontributet e arkëtuara të FSKP-së arritën vlerën prej 213.5 milionë euro në fund të vitit 2021, një rritje vjetore për 9.8 përqind krahasuar me një vit më parë.

FKPK realizoi kthim bruto nga investimet në vlerë prej 227.3 milionë euro në vitin 2021, që përbën rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak ku kthimi bruto në investime arriti vlerën prej 71.9 milionë euro. Kontribut kyç në kthimin në investimeve kishte performanca e fondeve në tregjet financiare ndërkombëtare, ku edhe janë të koncentruara mjetet e FSKP-së.

Sektori i sigurimeve


Sektori i sigurimeve u karakterizua me nivel të lartë të primeve të shkruara megjithë rritjen e nivelit të dëmeve të paguara, performancë të mirë financiare si dhe me rritje të nivelit të kapitalizimit.

Asetet e sektorit të sigurimeve përfaqësuan 2.7 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar në fund të vitit 2021 (grafik 33). Vlera e gjithsej aseteve arriti në 238.9 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 9.3 përqind. Në kuadër të aseteve, rritjen më të theksuar shënoi kategoria e depozitave të mbajtura në bankat komerciale, që janë kryesisht në formë të depozitave të afatizuara. Kategoria e dytë me rritjen më të lartë ishte ajo e investimeve në Letrat me Vlerë të Qeverisë së Kosovës. Kurse, pozicioni i huasë dhe të arkëtueshmet, dhe pozicioni i parasë dhe depozitave në BQK, ishin të vetmet kategori që shënuan rënie krahasuar me vitin e kaluar.

Sa i përket detyrimeve të sektorit, provizionet teknike dhe matematike përbëjnë pjesën më të madhe me gjithsej 63.7 përqind, pasuar nga ekuiteti me 27.3

përqind dhe pjesa e mbetur nga detyrimet tjera. Vlera e gjithsej kapitalit të sigurveve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje të theksuar, prej 15.5 përqind.

Grafik 33. Asetet e sektorit të sigurimeve



Burimi: BQK.


Rritja e kapitalit kundrejt vitit të kaluar i atribuohet kryesisht fitimit të realizuar gjatë vitit 2021, pasi që kapitali aksionar i paguar mbeti i pandryshuar me vitin 2020.

Vlera e primeve të shkruara nga sigurvezit në vitin 2021 arriti në 117.4 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.2 përqind (0.1 përqind në vitin 2020). Struktura e primeve të shkruara dominohet nga primet e sigurimit “jojetë” të cilat përfaqësojnë 95.9 përqind të gjithsej primeve të shkruara dhe pjesa e mbetur prej 4.1 përqind nga sigurimi “jetë”. Rritja e theksuar e nivelit të primeve të shkruara dhe polisave të shitura krahasuar me vitin e kaluar reflekton aktivitetin e shtuar ekonomik dhe lehtësimin e masave kufizuese për parandalimin e COVID-19.

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e sigurveve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan rritje për 24.4 përqind, duke arritur vlerën në 61.0 milionë euro në fund të vitit 2021 (49.1 milionë euro në vitin 2020) (grafik 34). Nga gjithsej shuma e dëmeve të paguara, 50.8 milionë euro (43.2 milionë euro në vitin 2020) ishin dëme të paguara

nga sigurvezit, ndërsa 10.2 milionë euro (5.8 milionë euro në vitin 2020) dëme të paguara nga BKS-ja.

Grafik 34. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK.

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit dhe BKS-ja ndër tjerash është rezultat i masave më lehtësuese kundër përhapjes së pandemisë, të aplikuara në Kosovë gjatë vitit 2021 krahasuar me masat më të rrepta gjatë vitit të kaluar që u reflektuan në nivel të reduktuar të lëvizjes dhe rrjedhimisht të dëmeve të ndodhura dhe paguara.

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve këtë vit e mbylli me rezultat pozitiv financiar prej 8.7 milionë euro, për dallim nga viti i kaluar ku kishte shënuar fitim neto në vlerë prej 2.3 milionë euro. Niveli më i lartë i fitimit të realizuar në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak është kryesisht rrjedhojë e nivelit më të lartë të të hyrave nga primet e shkruara (për 18.2 përqind). Niveli i dëmeve të ndodhura këtë vit u rrit për 25.3 përqind, kurse shpenzimet neto operative të sektorit gjatë kësaj periudhe shënuan rënie vjetore prej 4.0 përqind krahasuar me vitin 2020.

Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar u zgjerua gjatë vitit 2021, financiar kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm dhe atë të brendshëm si dhe kapitalit vetanank. Sektori shënoi rritje të theksuar të aktivitetit kreditor, duke kompensuar rënien e një viti më parë, përderisa aktiviteti i lizingjeve vazhdoi trendin rritës. Sektori vazhdon të ketë cilësi të lartë të portfolis kreditore, me nivel të ulët të kredive me probleme.


Asetet

Sektori mikrofinanciar regjistroi rritje vjetore të aseteve prej 7.5 përqind (1.8 përqind rritje vjetore në dhjetor 2021), vlera e të cilave arriti në 338.9 milionë euro në fund të dhjetorit 2021. Edhe pse ritmi i rritjes së aseteve u përshpejtua kundrejt rritjes së ngadalësuar të vitit paraprak, rritja e aseteve mbeti në nivel dukshëm më të ulët krahasuar me nivelin e rritjes dy vite më parë (dhjetor 2019) (grafik 35).

Sektori shënoi rënie të theksuar në zërat e parasë së gatshme dhe bilancit me bankat komerciale, përderisa shënoi rritje dyshifrore në kredi dhe lizingje. Ndryshimet në strukturën e aseteve të sektorit sygjeronjë orientimin e mjeteve drejt rritjes së aktivitetit kreditor. Këto lëvizje në sektorin mikrofinanciar pasqyrojnë rikthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik në vend, sidomos gjatë tremujorit të tretë, bazuar në lirimin e masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19, numrit të madh

të vizitave nga diaspora dhe rritjes së remitencave.

Grafik 35. Asetet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Kreditë

Gjithsej kreditë e lëshuara nga sektori mikrofinanciar shënuan rritje të përshpejtuar për 16.6 përqind në dhjetor 2021, përderisa stoku i tyre arriti në 238.3 milionë euro. Kreditimi u rrit për të dy agjentët ekonomik, korporatat jo-financiare dhe ekonomitë familjare. Kreditimi ndaj ekonomive familjare shënoi rritje vjetore prej 16.1 përqind (9.4 përqind rënie vjetore në dhjetor 2020), duke arritur vlerën 155.6 milionë euro në fund të dhjetorit 2021 (grafik 36).

Grafik 36. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe korporatave jofinanciare




Burimi: BQK.

Stoku i kredive ndaj korporatave jo-financiare arriti vlerën prej 82.7 milionë euro, që paraqet një rritje

**Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë
Nr. 37, Tremujori IV/2021**

vjetore prej 17.8 përqind (rënie vjetore prej 2.4 përqind në dhjetor 2020).

Grafik 37. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë




Burimi: BQK.

Në aspekt sektorial, kreditimi ndaj të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi rritje të përsheptuar. Rritjen më të lartë e shënoi sektori i shërbimeve financiare, pasuar nga sektori i 'shërbimeve tjera' (grafik 37).

Lizingjet

Lizingjet vazhduan trendin rritës, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me ritmin e rritjes para pandemisë.

Grafik 38. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Aktiviteti i lizingut shënoi rritje vjetore prej 14.3 përqind (8.8 përqind në vitin 2021), duke arritur vlerën prej 65.5 milionë euro në fund të dhjetorit 2021.

Kjo rritje kryesisht reflekton lizingun ndaj korporatave jo-financiare, vlera e të cilit arriti në 38.7 milionë euro e që paraqet rritje vjetore prej 23.2 përqind (grafik 38).


Lizingu ndaj ekonomive familjare kishte rritje të ngadalësuar krahasuar me atë të korporatave jofinanciare, duke shënuar rritje vjetore prej 7.3 përqind (3.3 përqind në dhjetor 2020), përdërisa vlera e përgjithshme e tyre në shtator 2021 arriti në 26.8 milionë euro.

Normat e Interesit

Norma mesatare e interesit në kreditë e lëshuara nga ky sektor në dhjetor 2021 qëndroi në 19.4 përqind, që është për 0.9 pikë përqindje më e ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (grafik 39).

Norma e interesit për kreditë e ekonomitë familjare shënoi rritje për 0.1 pikë përqindje, në 21.8 përqind (grafik 39). Sipas kategorive të kredive, tek kreditë hipotekare, norma mesatare e interesit u rrit për 0.3 pikë përqindje në 19.6 përqind. Njëkohësisht, edhe për kreditë konsumuese, norma e interesit u rrit për 1.1 pikë përqindje, në 23.0 përqind.


Grafik 39. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Për korporatat jo financiare, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar për 0.9 pikë përqindje, në 17.4 përqind. Sipas sektorëve ekonomik, normë më të favorshme të interesit kishin kreditë e orientuara për sektorin e shërbimeve, pasuar nga kreditë për sektorin e bujqësisë me normë interesi 15.9 përqind dhe 19.0 përqind, respektivisht (grafik 40).

Grafik 40. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK.


Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar vitin 2021 e mbylli me fitim neto në vlerë prej 14.3 milionë euro, kundrejt fitimit prej 0.1 milionë euro të realizuar në vitin 2020. Ky fitim ishte më i larti i shënuar që nga konsolidimi i sektorit.

Të hyrat e sektorit deri në dhjetor 2021 shënuan vlerën prej 48.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.1 përqind. Rritja kryesisht i'u atribua rritjes së të hyrave nga jo-interesit, më saktësisht të hyrave tjera operative për 1.1 milionë euro (grafik 41). Përderisa, të hyrat nga interesi shënuan rritje vjetore prej 2.7 përqind.

Shpenzimet e sektorit zbritën në 33.7 milionë euro nga 45.2 milionë euro sa ishin në dhjetor 2020, e që paraqet rënie vjetore prej 25.4 përqind.


Grafik 41. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK.

Rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton uljen e shpenzimeve nga jo-interesi, saktësisht provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë. Njëkohësisht, shpenzimet nga interesi shënuan rënie, ndërsa shpenzimet operative shënuan rritje.

Grafik 42. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK.

Si rrjedhojë e përmirësimit të performancës së sektorit, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave shënoi përmirësim të dukshëm, duke u zvogëluar për 29.0 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke qëndruar në nivel prej 70.7 përqind në dhjetor 2021.

Performanca financiare e sektorit u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e aseteve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rritje të konsiderueshme në vitin 2021 në 4.6 përqind dhe 18.4 përqind, përkatësisht krahasuar me vlerat e ulëta në dhjetor 2020 (grafik 42).

Grafik 43. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Sa i përket treguesve të cilësisë së portofolios kreditore të institucioneve mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe kishin mbulueshmëri të lartë me provizione. Saktësisht, në dhjetor 2021 kreditë jo-performuese zbritën tutje në 2.4 përqind nga 3.0 përqind sa ishin në dhjetor 2020. Ndërsa, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione arriti në 141.6 përqind nga 143.0 përqind në vitin 2020 (grafik 43).

Tregu i letrave me vlerë

Në vitin 2021, Qeveria e Kosovës realizoi 18¹² ankande të emetimit të letrave me vlerë duke emetuar borxh në vlerë më të ulët se sa në


periudhën e njëjtë të vitit 2020. Kërkesa për investim në këto ankande vazhdon të tejkaloj ofertën e qeverisë.

Grafik 44. Shuma dhe maturiteti i borxhit të emetuar, ndryshimi vjetor



Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës në vitin 2021 shënoi rënie vjetore prej 17.1 përqind krahasuar me vitin paraprak, duke rezultuar në vlerën prej 306.8 milionë euro (grafik 44).

Grafik 45. Shuma e ofruar dhe emetuar




Përderisa, nëse e krahasojmë emetimin e borxhit në periudhë tremujore, atëherë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, vlera e emetimit të letrave me vlerë ishte më e ulët që prej fillimit të emetimit (20.6 milionë

¹² Dy nga tetëmbëdhjetë ankandet e realizuara në vitin 2021 ishin emetime të bonove të thesarit për diasporën.

euro emetim, nga mesatarja historike prej 68.3 milionë euro).

Grafik 46. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Mungesa e tregjeve financiare në vend, si dhe mundësitë e kufizuara për investime alternative të mjeteve pasqyrohet në kërkesën për letra me vlerë të Qeverisë që vazhdimisht tejkalon ofertën përkatëse. Konkretisht, kërkesa për të investuar në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës ishte për 1.63 herë më e lartë se sa shuma e ofruar. Norma mesatare e interesit në

letrat me vlerë në vitin 2021 ishte 2.1 përqind, ngjashëm me normën në TM4 2021 (grafik 45).

Struktura e letrave me vlerë dominohet nga fletë-obligacionet qeveritare, me maturitet prej 3 vite, pasuar nga ato me maturitet prej 5 dhe 7 vite (grafik 46).

Fondet pensionale, sektori bankar, institucionet publike dhe kompanitë e sigurimeve vazhdojnë të jenë institucionet investuese kryesore në tregun primar të letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, ku sektori pensional vazhdon të jetë më i ekspozuari me rreth 54 përqind të gjithsej stokut të borxhit të brendshëm. Sektori bankar ka ekspozim me rreth 41 përqind të gjithsej stokut të borxhit të brendshëm dhe pjesa e mbetur nga sektori i sigurimeve (5 përqind).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK: Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë nr. 37, TM4 2021, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK:

- a) Buletini Mujor Statistikor: [Buletini Mujor Statistikor | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://www.bqk-kos.org)
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: [Seritë Kohore | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës \(bqk-kos.org\)](http://www.bqk-kos.org)

ASK:

- a) Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/>
- d) Repertori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/>

Të tjera:

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës: [Ballina | FKPK \(trusti.org\)](http://www.ballina.org)

Bloomberg: Metal Prices database: [Commodities - Bloomberg](https://www.bloomberg.com/commmodities)

FAOUN: World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor: Euribor Historical Rates: <http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF: World Economic Outlook: World Economic Outlook (imf.org)

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2020	2021
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	6,771.6	7,816.6
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.2%	3.4%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	0.1%	6.7%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,731.3	2,200.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	2,216.6	2,268.4
Bilanci primar (në milionë euro)	-485.3	-67.9
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,919.2	8,925.6
prej të cilave: Bankat	5,365.3	5,959.5
Kredi	3,246.6	3,748.6
Depozita	4,360.9	4,901.8
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.0%	5.8%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.5%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	4.5%	4.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse	-472.2	-691.2
prej të cilave: remitencat e pranuar	980.1	1147.8
Llogaria financiare	-560.9	-438.7
Investimet e huaj direkte në Kosovë	345.7	421.0
Investimet portfolio, net	-81.7	277.2
Investimet tjera, net	-238.9	-563.3
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-753.4	-723.6
Asetet	5,201.5	6,112.1
Detyrimet	5,954.9	6,835.8
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,361.3	2,841.1
Borxhi i jashtëm privat	1,863.8	2,078.7
Borxhi i jashtëm publik	497.4	762.5

Burimi:

1/ ASK.

2/ MF.

3/ BQK.

*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në shtator 2021.

